



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni vjeshtor

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr.04

Prishtinë, më 7.11.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Mufera Shinik, Arbërie Nagavci, Adem Mikullovc, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekalju, Abdyl Salihu, Nezir Çoçaj, Verica Qeraniq dhe Albulena Balaj-Halimaj, anëtarë.

**Mungoi:** Teuta Haxhiu.

**Përfaqësues të ftuar:** Shyqiri Bytyçi, ministër i MASHT.

**Përfaqësues të tjerë:** Flora Kryeziu-UNICEF, Kushtrim Bajrami-KEC, Rinor Qehaja-EDGUARD, Valdrin Dervishaj-KOMF, Qëndresa Ibrahim-KYC dhe përfaqësues të medias.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

**Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i komisionit.**

**Në këtë mbledhje u propozua ky**

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.10.2017;**
- 3. Diskutim lidhur me programin legjislativ dhe prioritetet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i ftuar z. Shyqiri Bytyçi, ministër i MASHT;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.10.2017**

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më datë 24.10.2017, u miratua pa vërejtje.

## **3. Diskutim lidhur me programin legjislativ dhe prioritetet e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)**

Kryetari i komisionit, në fillim të mbledhjes, tha se komisioni ka ftuar ministrin Shyqiri Bytyçi, me qëllim të informimit nga ministri për fushat që i mbulon, rreth programit dhe prioritetëve të kësaj ministrie. Fjala iu dha ministrit të MASHT.

**Ministri Shyqiri Bytyçi**, në fillim të diskutimit të tij, prezantoi në mënyrë të përgjithshme prioritetet dhe planet në këtë ministri. Gjatë prezantimit, ai paraqiti objektivat, sipas fushave, siç janë: transformimin e arsimit parashkollor, bazuar në programet e punës së institucioneve në vendet e zhvilluara, avancimin dhe adaptimin e modeleve të punës në arsimin parauniversitar, reformat në arsimin e lartë, avancimin e stafit akademik etj.

Ministri tha se duhet të merren hapa konkret për ta modifikuar arsimin parauniversitar në shumë segmente, duke filluar nga ndryshimi i modelit të organizimit nga klasa 1-5, klasifikimi i mësimdhënësve dhe trajnimi i tyre. Po ashtu, ai tha se në plan të reformimit është edhe organizimi i mësimin nga klasa 6-9, angazhimi i psikologëve, avancimi i shkollave profesionale, vlerësimi i testit të maturës. Sa i përket mësimin tërëditor, ministri Bytyçi theksoi se nuk ka hapësirë të mjaftueshme shkollore dhe tashmë ministria ka një raport të detajuar për nevojën shtesë të hapësirave shkollore, për ta realizuar mësimin tërëditor, për të cilën tha se duhet të diskutohet me Qeverinë, Kuvendin dhe donatorët për gjetjen e një zgjidhjeje të kostos financiare për ndërtimin e shkollave të reja.

Ministri Bytyçi prezantoi edhe programin legjislativ për periudhën e mbetur të vitit 2017, duke bërë të ditur se ministria që ai drejton i ka vlerësuar si prioritare tri projektligje: Projektligjin për inovacion dhe transfer të dijes dhe teknologjisë, Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të MASHT-it dhe SPARK-ut, si dhe Projektligjin për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës.

Në vijim, ministri prezantoi edhe programin legjislativ për vitin 2018, i cili, sipas tij, ndër të tjera përfshin: Projektligjin për Arsimin e Lartë, Projektligjin për tekstet dhe mjetet shkollore, lekturë shkollore, Projektligjin për edukimin parashkollor, Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të viteve 1990/99 dhe Projektligjin për arsimin dhe aftësimin profesional.

**Ismajl Kurteshi**, tha se nga diskutimi i ministrit u përmenden prioritetet e ministrisë në reformat, ndryshimin e modeleve, klasifikimin e mësimdhënësve në arsimin parauniversitar. Në këtë rast, ai tha se në diskutim nuk u përmenden debatet publike para se të fillohet me këto reforma që do të ndihmonin në orientimin e reformave, modelet që planifikohen të aplikohen a

janë adekuate për vendin tonë, a janë bërë përgatitjet adekuate për zbatimin e kurrikulës së re, si do të bëhet ndryshe organizimi i testit të maturës, si dhe çështja e infrastrukturës shkollore. Sa i përket programit legjislativ, tha se projektligji për ratifikimin e marrëveshjes SPARK është shqyrtuar edhe në legjislaturën e kaluar dhe është konstatuar se i njëjti ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën, andaj kërkohet nga ministri që të ketë parasysh këtë çështje. Sa i përket Projektligjit për inspektoratin e arsimit, tha se i njëjti ka qenë në proces të shqyrtimit në mandatin e kaluar, por nuk ka arritur të miratohet.

**Arbërie Nagavci**, tha se nga diskutimi dhe prezantimi i objektivave të ministrisë, shumë gjëra janë të përgjithësuara dhe nuk janë të specifikuara, gjë që e bën të vështirë që ta kemi të qartë se çka dhe sa janë realizuar këto objektiva. Për faktin se fusha e arsimit ka specifikat e veta, kishte qenë mirë që në takimet e radhës të komisionit të diskutohet sipas niveleve të arsimit në takime të veçanta. Sa i përket reformave shkollore, tha se reformat nuk kanë munguar asnjëherë, mirëpo rezultatet nuk kanë qenë të kënaqshme. Ajo ngriti edhe çështjen e buxhetit, kur u përmend planifikimi i ndërtimit të infrastrukturës shkollore, ngritjen e cilësisë në arsim, përgatitjet për programin Montesori në arsimin parashkollor, mësimin tërëditor, çështjen e vlerësimit të testit të maturës, kornizën e kurrikulës etj.

Sa i përket shkarkimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, ministria ka obligim ligjor ta njoftojë Kuvendin për arsyet e shkarkimit të tyre, ndërsa lidhur me propozimin për emërimin e anëtarëve të rinj të Këshillit tha se është bërë shkelje e rregullores së Këshillit me rastin e caktimit të kryesuesit dhe zëvendësit të tij, njëkohësisht kërkoi nga ministri ta sqaroi se kur do të procedohen emrat e Këshillit për ratifikim në Kuvend.

**Nezir Çoçaj**, tha se plani i paraqitur nga ministri është ambicioz dhe në këtë situatë, çfarë është Kosova, ka dyshime se këto plane mund të realizohen për një mandat qeverisës. Ai tha se një ndër sfidat është edhe çështja e edukimit parashkollor, si dhe mungesa e objekteve parashkollore në shumë komuna. Sa i përket modelit të arsimit nga klasa 1-5, të prezantuar nga ministri, kërkoi sqarim se a do të ketë staf mësimdhënës për këtë model të arsimit. Ai ngriti çështjen e mungesës së stafit adekuat në Fakultetin e Edukimit për përgatitjen e mësimdhënësve të rinj, si dhe çështjen e trajnimit të mësimdhënësve nga Instituti Pedagogjik dhe Fakulteti i Edukimit, gjë që sipas tij, nuk është në rregull që Fakulteti i Edukimit t'i trajnojë kuadrot që i ka përgatitur vet. Sa i përket Inspektoratit të Arsimit, tha se për t'i ikur ndikimit të ministrit në këtë institucion duhet të pavarësohet nga ministria, e jo të mbetet si departament i saj. Kërkoi sqarim nga ministri lidhur me propozimin që statutet e universiteteve publike të miratohen nga ministria.

**Mufëra Shinik**, tha se shkollat kanë filluar me zbatimin e kurrikulave të reja, mirëpo mungojnë fletoret e punës dhe hartat shkollore në gjuhën e komuniteteve turke dhe boshnjake. Problem tjetër i trashëguar është edhe çështja e nostrifikimit të diplomave, dhe si do ta tejkaloni këtë problem, ndërsa sa i përket pedagogëve dhe psikologëve, tha se në ato shkolla ku mësimi zhvillohet në gjuhën turke dhe boshnjake, mungojnë pedagogët dhe psikologët, andaj kërkoi nga ministri një planifikim më të mirë për këtë çështje.

**Valentina Bunjaku-Rexhepi**, u fokusua në çështjen e shkarkimit të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, për të cilin kërkoi sqarim nga ministri lidhur me shkeljet ligjore, ngase sipas ligjit, thuhet se nëse 1/3 e anëtarëve të bordit ndërrohet, ministri duhet ta njoftojë Kuvendin, gjë që nuk është bërë. Sa i përket çështjes së pedagogëve dhe psikologëve, kërkoi

sqarim lidhur me planifikimet buxhetore për këtë kategori. Më tej, ngriti çështjen e nxjerrjes së një ligji për konvikte, mungesën e udhëzimit administrativ për ndarjen e fondit të orëve për mësimdhënës, si dhe çështjen e planifikimit të ndërtimit të objektit për Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan.

**Adem Mikullovc**i, ngriti shqetësimin e tij rreth çështjes së akreditimit të disa programeve të doktoratës në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës, gjatë kohës së rektorit Ibrahim Gashi. Sipas tij, një gjë e tillë nuk ndodh në asnjë vend të botës, ngase nuk ka program të doktoratës pa teori, ndërsa tek ne, doktoron interpretuesi (aktrim, muzikë, regjisor, dirigjent, pikturë etj.). Kjo kategori mund të marrë tituj meritore, por jo doktoraturë. Çështja tjetër, të cilën e ngriti, kishte të bënte me numrin e asistentëve, zëvendësministrave dhe këshilltarëve në Kabinetin e Ministrit.

**Albulena Balaj- Halimaj**, tha se shpreson që prioritetet e prezantuara nga ministri do të realizohen, duke pasur parasysh se ato janë të bazuara me gjendjen e arsimit në Kosovë. Çështje me rëndësi, tha se është ngritja e nivelit të arsimit profesional, për të cilën kërkoi që ministria të bashkëpunojë me bizneset, në mënyrë që shkollat profesionale të jenë më tërheqëse për të rinjtë. Çështje tjetër, të cilën e ka ngritur edhe në Kuvend, ka të bëjë me mësimdhënësit me probleme të rënda shëndetësore, të cilët detyrohen të dalin në vendet e tyre të punës, për shkak të pagës. Kërkoi nga ministri që të marrë masa për identifikimin e rasteve të tilla në nivel vendi dhe të shikojë mundësinë e sigurimit të një fondi për raste të tilla.

**Ministri Bytyçi**, iu përgjigj anëtarëve të komisionit në çështjet e ngritura, si dhe shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me komisionin për synimet e përbashkëta, në funksion të ngritjes së cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet.

#### **4. Të ndryshme**

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

*E përgatiti:*  
*Stafi mbështetës i komisionit.*

Kryetari i komisionit,

-----  
Ismajl Kurteshi